



KOMISIONI I GARAVE I SUPERLIGËS dhe LIGËS SË PARË, duke u mbështetur në nenin 81 të Rregullorës së Garave të FFK-së, nenin 51 dhe 52, paragrafi 1, pika d) të Propozicionet e Garave, si dhe në nenin 60, paragrafi 1, pika e), nenit 97, pika f) të Rregullorës Disiplinore të FFK-së, në seancën e vet mbajtur me datën 11.04.2024, duke vendosur lidhur me regjistrimin e ndeshjeve të javës së 21-të Raiffeisen Liga e Parë Grupi B, lidhur me parregullsitë e ndeshjes Ulpiana- Vllaznia Pozheran, merr këtë:

V E N D I M

- I. ANULOHET** – sipas detyrës zyrtare ndeshja Raiffeisen Liga e Parë Grupi B e zhvilluar ndërmjet KF Ulpiana- KF Vllaznia Pozheran java 21 e përfunduar me rezultat 3:4 në favor të KF Vllaznia (P), dhe e njejta regjistrohet si ndeshje e luajtur dhe rezultati i saj nuk regjistrohet, po ashtu pikët dhe golat e shënuara nuk do të regjistrohen në tabelën e klasifikimit të ligës përkatëse.

A r s y e t i m

Komisioni i Garave me rastin e regjistrimit të ndeshjeve të Raiffesien Liga e Parë Grupi B në kuadër të javës së 21-të, ka konstatuar se ndeshja Ulpiana- Vllaznia P ka qenë e kurdisur. Bazuar në deklaratën e personit zyrtar të FFK-së dhe xhirimit televiziv të ndeshjes, konform nenit 97 pika F, të Rregullores Disiplinore është vërtetuar mosangazhimi në lojë i ekipit vendas, sipas nenit 60 paragrafi 1 pika E, e Rregullores Disiplinore parashihet që “*mosangazhimi në lojë*” (lëshimi i qëllimshëm i kundërshtarit të shënoj gol pa angazhim, angazhimi inert, mos dëshirë për lojë, dëmtim i ekipit të tij me qëllim), komunikimi në mes të disa lojtarëve me SMS lidhur me zhvillimin dhe rezultatin e ndeshjes si dhe të dhënat nga raportet tjera konfidenciale.

Bazuar në deklaratat e personave zyrtar të FFK-së, shikimi i xhirimeve televizive të ndeshjes, analizimi i raporteve konfidenciale per rastin, u konstatua se kemi të bëjmë me kurdisjen e rezultatit të ndeshjes, andaj konform nenit 81 të Rregullores së Garave, anulohet ndeshja sipas detyrës zyrtare dhe kjo ndeshje regjistrohet si ndeshje e luajtur, rezultati i kësaj ndeshje nuk regjistrohet, gjegjësisht pikët dhe golat nuk regjistrohen në tabelat e klasifikimit të Ligës së Parë Grupi B.

Mbështetur në nenin 51, paragrafi 1 të Propozicionet e Garave parashihen se “*Në rast të sjelljes jo sportive, shkeljes së Statutit, rregulloreve dhe vendimeve të FFK-së, trupat juridike të FFK-së kanë autorizim të aplikojnë masat disiplinore dhe vendimet në harmoni me këtë Statut dhe Rregulloret Disiplinor*”. Për më tepër në nenin 52, paragrafi 1, pika d) të po të njëjtës Rregulloreje përcaktohen masat disiplinore që mund të shqiptohen kundër anëtarëve, klubeve apo personave juridik, në pikën d) të këtij neni parashihet masa



FEDERATA E FUTBOLLIT E KOSOVËS
FUDBALSKI SAVEZ KOSOVA
FOOTBALL FEDERATION OF KOSOVO

“anulimi i rezultatit të ndeshjes” si një ndër masat disiplinore që mund të shqiptohen në rastet e sjelljes jospportive.

Andaj, konform të lartcekurat dhe nenit 81 të Rregullores së Garave të FFK-së, inicohet procedura disiplinore ndaj të gjithë personave të përfshirë dhe atë ndaj personave si në vijim:

- Ndaj klubit të futbollit Ulpiana;
- Ndaj personit zyrtar të KF Ulpiana Meriton Isufi me ID-së 020334M05;
- Ndaj lojtarit me nr. 12 Ridon Llugiqi me ID 006950M04;
- Ndaj lojtarit me nr.25 Gentian Emini me ID 005592M97;
- Ndaj lojtarit me nr. 23 Samet Rexhepi me ID 037333M03;
- Ndaj klubit të Futbollit Vllaznia Pozheran;
- Ndaj personit zyrtar të KF Vllaznia P, Agron Pira me ID 024546M85

Duke pasur parasysh të gjitha këto që u cekën më lartë dhe duke u mbështet në Rregulloret e FFK-së u vendos si në dispozitiv të këtij vendimi.

Datë 11.04.2024

Komisioni i Garave
Abdyl Bellopoja-Kryetar

Vendimi i dërgohet:

- 1.Klubit të Futbollit Ulpiana nga Lipjani;
- 2.KF Vllaznia (P); nga Pozherani-Viti
- 3.Arkivës së FFK-së

Këshillë Juridike: Kundër këtij vendimi palët e pa kënaqura mund të paraqesin ankesë në Komisionin për ankesa të FFK-së, shkalla e dytë në afat prej 8 ditësh nga dita e pranimit të vendimit ose publikimit në faqen zyrtare të FFK-së. Ankesa nuk e shtyen ekzekutimin e këtij vendimi.